



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
___. ___. 2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr.196, datë 12.05.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brunilda Kadi,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

•
•
•
•
•
•
•

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN) E
GJYQTARIT {...}



EKSTRAKT

POLI I DREJTËSISË
RRUGA "ANA KOMNENA"
TIRANË



VLERËSIMI DHE PIKËZIMI PËR AFTËSITË E GJYQTARES SIPAS KRITEREVE TË VLERËSIMIT

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: " Në tre dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vazhguara, është konstatuar se ai ka shqyrtuar mosmarrëveshje që kërkojnë njohuri në të drejtën administrative që lidhen me ; i) marrëdhëniet e punës në administratën publike që lindin nga emërimi (shih dokumenti nr 1 dhe dosja nr 4), ii) me marrëdhëniet e punës që lindin nga zgjedhja apo votimi (shih dosja nr 2), iii) me marrëdhëniet e punës që lindin nga kontrata (shih dosja nr 5), iv) me detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor (shih dokumenti nr 3) v) me ushtrimin e veprimtarisë së lojrave të fatit (shih dokumenti nr 2), vi) me legalizimin e ndërtimeve informale (shih dosja nr 1), vii) me regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shih dosja nr 3). Në një rast njohuritë e tij përsa i përket interpretimit të ligjit procedural civil që lidhet me provat dhe forminin e ndërgjyqësisë nuk janë konfirmuar nga gjykata e apelit (shih dosja nr 5)...".

Në përmbajtjen e vendimeve përfundimtare evidentohet aftësi shumë e mirë e gjyqtarit për të përcaktuar faktet e çështjes. Gjyqtari harton vendimet me tekst unik, ku në shumicën e vendimeve, fillimisht paraqiten rrethanat e çështjes në mënyrë të përmbledhur, siç janë konstatuar gjatë gjykimit, më pas

paraqiten pretendimet e palës paditëse dhe prapësimet e palës së paditur. Në lidhje me arsyetimin e gjykatës, në shumicën e vendimeve, karakteristikë e gjyqtarit është se arsyetimi nuk është i ndarë më vehte, por është e integruar në paraqitjen e pretendimeve apo prapësimeve të palëve si dhe provave, në mbështetje të rrethanave të faktit që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit. Evidentohet qartë aftësia e gjyqtarit për të përcaktuar natyrën thelbin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Nga vëzhgimi i dosjeve, evidentohet referimi i dispozitave të ligjeve ose akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në secilën çështje, të tilla si; Ligji “Për inspektimin e ndërtimit”, Ligji “Për planifikimin e territorit”, (dosja 1), Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(dosja 2), Ligji “Për rregjistrimin e pasurive të paluajtshme”(dosja 3), Ligji “Për policinë e burgjeve”, Urdhëri i Ministrisë së Drejtësisë “Për rregullat e hollësishme të sjelljes të punonjësve të policisë së burgjeve”, Rregullore “Për përcaktimin e rregullave për marrëdhënien e punës, trajtimin, ecurinë në karrierë dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit e policisë së burgjeve” (dosja 4), Kodi i Punës (dosja 5, 7, 9), Ligji “Për përlllogaritjen e pensioneve” (dosja 6), Ligji “Për procedurat tatimore” (dosja 8), Ligji “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, (dosja 10, 11) etj.

Në vendimet përfundimtare të analizuara, evidentohet *identifikimi i normës/normave ligjore dhe nënligjore konkrete* në lidhje me çështjen në shqyrtim, dhe zbatimi i tyre në shërbim të arsyetimit për çdo kërkim të objektit të padisë. Gjyqtari ka referuar, cituar dhe arsyetuar, në disa raste, dispozitat të ligjit procedural civil, të ligjit 49/2012 dhe ligjit material të posaçëm në lidhje me legjitimin aktiv/pasiv, procedural apo material të palëve, kompetencën lëndore të gjykatës administrative në raport me llojin e mosmarrëveshjes dhe shkakun ligjor të padisë sipas parashikimeve të ligjit, cilësinë e vendimit si të paankimueshëm për shkak të vlerës së padisë dhe interpretim të dënimit plotësues, këto sipas nenit 45 të ligjit nr.49/2012.

Nga vëzhgimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore, evidentohet njohje dhe zbatim i ligjit si dhe dispozitave procedurale të referuara në mbështetje të vendimeve të ndërmjetme, gjatë zhvillimit të seancave dhe në përfundim të tyre. Në aspektin procedural, në 11 dosjet e vëzhguara, rezultojnë se përdoren referenca të sakta të dispozitave lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale.

Sa i përket konfliktit të normave, nuk evidentohet të jetë pasqyruar ndonjë konflikt i normave procedurale ose material në vendimet e vëzhguara, referuar kjo edhe natyrës së çështjeve të trajtuara.

Në tërësi, referuar të dhënave që evidentohen nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë për identifikimin e qartë dhe të saktë të natyrës së çështjes si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim mbi secilin fakt.

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësi e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“...Gjyqtari {...} ka njohuri në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit.. Gjyqtari njeh parimet e përgjithshme procedurale gjatë gjykimit dhe në funksion të zgjidhjes së çështjes identifikon fushën e zbatimit të normës ligjore përkatëse (shih nenin 4 të K.Punes) duke referuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes tek ligjet e veçanta dhe materiale (shih dokumenti nr 1, dosja nr 2 dhe nr 4), ligjin material (shih dokumenti nr. 3), ligjet organike apo specifike (shih dokumenti nr 2, dosja nr 1, nr 3, nr 4), përdor aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit (shih dokumenti nr 1 dhe dosja nr 4). Gjyqtari në vendimet e hartuara prej tij nuk ka përdorur shprehimisht parimet e veçanta në fushat e së drejtës, por në një rast ka cituar pranimin e veprimit të ligjit në kohë dhe në hapësirë (shih dokumenti nr 1), gjyqtari nuk ka referenca në vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë apo të praktikës gjyqësore...”*

Në vendimet përfundimtare të gjyqtarit identifikohet, norma ligjore dhe kur është rasti citohet. Gjyqtari në vendimet përfundimtare të tij, në përgjithësi nuk bën një interpretim të normave të ligjit, por i citon ato në funksion të zgjidhjes së çështjes konkrete dhe në shërbim të analizës së fakteve, duke sjellë si rrjedhojë llogjike konkluzionin e arritur në lidhje me zbatimin e saj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga vendimet e vëzhguara evidentohet që gjyqtari i zbaton në çdo rast, por pa përmendur shprehimisht elementë të tyre. Ndërkohë, nisur nga përmbajtja e vendimeve përfundimtare të vëzhguara, rezultojnë të jenë zbatuar drejtpërdrejtë aspekte të parimit të procesit të rregullt ligjor në lidhje me respektimin e të drejtave procedurale të palëve ndërgjyqëse, kontradiktoritetin, dispon{...}itetin e padisë nga pala paditëse në përcaktimin e objektit të padisë, etj.

Gjithashtu, nga vendimet e vëzhguara evidentohet mungesë reference në praktikën gjyqësore të konsoliduara, praktikën e unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë etj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësohet se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare për të interpretuar ligjin në funksion të zgjidhjes së çështjes, pasi bën

⋮

vetëm referim formal të ligjit, të pashoqëruar me një analizë të dispozitave, raportit midis tyre dhe zbatimit mbi rrethanat e faktit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; *“...Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetura janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari....Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe në tërësi përdor karakteret e gjuhës shqipe...”*

Vendimet përfundimtare të gjyqtarit janë në çdo rast të thjeshta, të lexueshme, të kuptueshme dhe koçize. Në veprimet për drejtimin e seancave gjyqësore dhe vendimet përfundimtare përdoret gjuhë e thjeshtë, e qartë, e kuptueshme dhe e drejtpërdrejtë.

Evidentohet në përgjithësi respektimi i rregullave drejtshkrimore, gramatikore dhe të sintaksës, por mungon përdorimi i të gjitha shkronjave të gjuhës shqipe (*nuk përdoren shkronja ë*). Në tekstet e vendimeve përdoren fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Evidentohet ndonjëherë edhe fjali të gjata, por që janë në funksion të mosndërprerjes së mendimit.

Organizimi dhe shprehja e mendimit në tekstet e vendimeve, gjuha e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, e bën të qartë, të thjeshtë dhe të kuptueshëm për të gjithë arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Nuk evidentohet të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren. Në rast kur referon në institutet e së drejtës, në ato pak raste që mund të hasen në vendimet e vëzhguara, gjyqtari i përmend në arsyetim duke i cituar në gjuhën shqipe, e në këtë mënyrë nuk krijon konfuzion në lidhje me kuptimin e tyre.

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 12 pikë.

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; *“..Struktura e vendimeve përmban 3 pjesë sipas kërkesave të ligjit procedural civil, pjesa përshkruese arsyetuese paraqitet me tekst unik me paragrafë të panumërtuar (dosja nr 3), me paragrafë të numërtuar (dosja nr 2), me nënpjesë (shih dokumenti nr 1, nr 3, dosja nr 4 dhe dosja nr 5). Vendimet janë të një formati standard sipas një metodologjie të caktuar (shih dokumentin nr 1,2,3 dhe dosjet nr 1,2,3,4 dhe 5....”*

Në aspektin strukturor, vendimet kryesisht kanë ndjekur një strukturë të mirë përcaktuar duke evidentuar qartë tri pjesët përbërëse të vendimit (pjesa hyrëse, arsyetimi, pjesa urdhëruese).

Pjesa hyrëse e të gjitha vendimeve përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohës së zhvillimit të gjykimit, të dhëna të plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, objektin dhe bazën ligjore të padisë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në mënyrë të përmbledhur.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese, në vendimet e përzgjedhura me short, ndiqet një strukturë e organizimit të vendimit, e cila fillon me përshkrimin e fakteve të çështjes objekt gjykimi, të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke i përshkruar në mënyrë të përmbledhur dhe duke interpretuar dhe provat shkresore mbi të cilat mbështet faktet e referuara. Më pas vijon me paraqitjen e pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, në të cilat paraqitet dhe analiza e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, duke i dhënë përgjigje pretendimeve të tyre. Në tri vendimet e zgjedhura nga gjyqtari, ndiqet një strukturë e organizimit të vendimit, e cila fillon me përshkrimin e fakteve të çështjes objekt gjykimi, të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim, duke vijuar me pretendimet e palës paditëse, prapësimet e palës së paditur, citimin e dispozitave ligjore, çështjeve që shtrohen për zgjidhje në rastin konkret dhe duke përfunduar me konkluzionin e gjykatës, e cila merr në analizë çështjet e shtruara për diskutim, duke i dhënë përgjigje dhe pretendimeve të palëve në padi.

Në pjesën e dispozitivit, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës për padinë, për ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore si dhe e drejta, afati dhe gjykata kompetente për ushtrimin e të drejtës së ankimit, data e shpalljes, Përsa i takon dispozitivit të vendimit, gjyqtari përdor teknikën e listimit të disponimeve duke i numërtuar ato, e cila lehtëson referencat në rastin kur vendimi ka disa disponime.

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësi e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se; *“...Gjyqtari {...} në 3 dokumentet ligjor të prezantuara prej tij dhe në 5 dosjet e përzgjedhura me short tregon se ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara janë të kuptueshme, përmbajnë pretendimet e palëve, analizën e provave dhe të ligjit për të treguar lidhjen midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në 1 rast mungon arsyetimi që lidhet me zgjidhjen e pasojave juridike të pavlefshmërisë së aktit administrativ (shih dosja nr 2)... Në vendimet përfundimtare, gjyqtari pasqyron dhe vendimet e ndërmjetme të gjykatës lidhur me pretendimet e palëve ndërgjyqëse; i) për ndryshimin e objektit të padisë (shih dokumenti nr 1), ii) për pushimin e pjesëshëm të gjykimit për shkak të heqjes dorë ndaj një pjese të palës së paditur (shih dokumenti nr 3), iii) për shtimin e bazës ligjore të padisë (shih dosja nr 1), iv) për shtimin e objektit të padisë (shih dosja nr 4), për kalimin procedural të palës së paditur (shih dosja nr 5). Gjithashtu, pjesë e arsyetimit ligjor është dhe dispozitivi i vendimit, ku në një rast është evidentuar se ndaj tij nuk lejohet ankim në një gjykatë më të lartë (shih dosja nr 1), në një rast nuk janë zgjidhur pasojat e pavlefshmërisë së aktit administrativ të kërkuar nga pala, por vendimi nuk është ankimuar (shih dosja nr 2). Përsa i përket vendimeve të ndërmjetme, nuk mungon shkak ligjor dhe disponimet e gjykatës (shih dosjet nr 1, 2, 3, 4 dhe 5). Nuk ka asnjë vendim të cënuar nga gjykatat më të larta për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit. Në këtë aspekt, ka pasur 1 ankesë në Inspektoriatin e KLD nga palët në vitin 2014 për mungesë të arsyetimit të vendimit gjyqësor, e cila pasi është verifikuar, është arkivuar si e pabazuar. Si konkluzion, rezulton se niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standartin e procesit të rregullt ligjor.”*

Në drejtim të cilësisë së analizës në arsyetimin e vendimeve, në përgjithësi vendimet e gjyqtarit përmbajnë parashtrim të rrethanave të faktit, referim ose citim të ligjit dhe zbatim të drejtpërdrejtë të tij mbi faktet e çështjes dhe kërkimet objekt padie. Në këto arsyetime në përgjithësi nuk evidentohet ndonjë analizë e pavarur e ligjit që zbatohet ose analizë e integruar me faktet. Përrjashtim bëjnë dy vendime, ku gjyqtari bën analizë të faktit dhe të ligjit dhe argumentim lidhur me aspekte të caktuara të tij në raport me faktet objekt gjykimi (dosja nr. 4 dhe 5). Kryesisht, në vendimet gjyqësore që i përkasin dosjeve të zgjedhura me short, gjyqtari, pasi ka parashtruar rrethanat e faktit të provuara në gjykim dhe ka paraqitur pretendimet e palëve ndërgjyqëse, referon ose citon dispozitat ligjore ose nënligjore që gjejnë zbatim në rastin konkret dhe i zbaton ato në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, pa i shoqëruar me interpretim të tyre, kjo e lidhur edhe me natyrën e çështjeve të vëzhguara. Ndërkohë, në tri dokumentet ligjore të zgjedhura, gjyqtari pasi parashtron rrethanat e faktit të provuara në gjykim, pretendimet e palës

paditëse, prapësimet e palës së paditur, citon dispozitat ligjore dhe akteve nënligjore dhe përcakton çështjet që shtrohen për zgjidhje në rastin konkret, përfundon me konkluzionin e gjykatës, lidhur me çështjet që janë shtruar për zgjidhje si dhe lidhur me kërkimet në padi, duke i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve dhe duke i shoqëruar me arsyetimin dhe vlerësimin e gjykatës në lidhje me to.

Në dy vendimet gjyqësore që i përkasin dosjes nr. 4 dhe 5, dhe vendimet e zgjedhura prej tij, gjyqtari citon dispozitat ligjore që janë vlerësuar të nevojshme të analizohen prej tij në raport me zgjidhjen e çështjes. Më pas, analiza ligjore paraqitet e veçantë dhe karakterizohet nga paraqitja e saj në mënyrë të koncentruar dhe konkrete vetëm për dispozitën ligjore ose institutin e marrë në analizë.

Në lidhje me analizën dhe argumentimin ligjor të pretendimeve të palëve, rezulton se janë analizuar të integruara në lidhje me normat konkrete të ligjit të marra në analizë dhe rrethanat e faktit mbi të cilat ato zbatohen. Arsyetimi i vendimeve në lidhje me kërkimet e palëve, është i plotë, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, duke respektuar në çdo rast standardet e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi ; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
92	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

•
•
•
•
•
•
•

2. A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara në këtë proces, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues është bërë duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësimin dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me këtë tregues, konkludohet se :”Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në interval kohore nga 1 muaj (shih dosjen 1), deri në 7 muaj (shih dosjen 5). Çështja që ka patur kohëzgjatjen më të lartë ka qenë çështje me objekt marrëdhënie pune, ku në përfundim të gjykimit është disponuar me vendim përfundimtar. Kjo çështje është prishur dhe është kthyer për rigjykim nga gjykata e apelit. Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 2 muaj (shih dosjen 2), 2 muaj dhe 16 ditë (shih dosjen 3), dhe 2 muaj e 12 ditë (shih dosja nr 4).”

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, nuk rezulton që për shqyrtimin e tyre, ligji të ketë parashikuar afat ligjor shqyrtimi. Të dhënat statistikore të administruara në dosje, nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afate për gjykimin. Dokumentat e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk kanë të dhëna të tjera që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi. Për pasojë, prezumohet se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet, për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit, prandaj duhet të vlerësohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.



2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në raportin e administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“...Në dosje të vëzhguara është konstatuar se afati standard i gjykimit prej 1 muaji është tejkaluar në 4 raste (shih dosja nr 2, 3, 4 dhe 5). Shkaqet për tejkalimin e afatit standard të gjykimit kanë qenë proceduriale. Përfundim në dosja nr 5, ku dy seanca janë caktuar tej afatit standart 1 muajor të përfundimit të gjykimit me 3 muaj e 25 ditë (shih seanca përgatitore nr 3) dhe tej afatit ligjor 5 ditor të diskutimit përfundimtar me 1 muaj e 10 ditë (shif seanca gjyqësore nr 3). Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, referuar të dhënave të vendimit, konstatohet se gjykimi ka zgjatur 3 muaj dhe 10 ditë (shih dokumenti 1), 1 muaj dhe 16 ditë (shih dokumenti 2) dhe 7 muaj e 16 ditë (shih dokumenti 3), duke tejkaluar afatin standard të gjykimit në të tre rastet, por duhet cituar se në të tre rastet nuk identifikohet shortimi i çështjes përkatëse. Nga verifikimi i 3 dokumenteve të prezantuara nga gjyqtari dhe 5 dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se në 7 prej tyre është tejkaluar afati standard 1 muajor kohor i gjykimit. Shkaku kryesor rezulton ngarkesa e lartë në aspektin sasior”.*

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit rezulton se për 10 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësimin, gjykimi ka zgjatur më tepër se standardi minimal kohor, ndërsa për 1 çështje të përzgjedhur me short, gjykimi ka zgjatur 1 muaj, i barabartë me standardin minimal kohor, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD. Kryesisht çështjet tej standardit minimal kohor kanë zgjatur nga 1 muaj e 11 ditë, deri në 7 muaj e 16 ditë.

Ndërkohë, nga analiza e mësipërme, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi *nuk është në koherencë* me parashikimet ligjore *në fuqi gjatë periudhës së vlerësimit*. Në vlerësimin e këtij treguesi, mbahet parasysh fakti që standardi minimal kohor 1 muajor për gjykimet administrative është përcaktuar në vitin

2010, ndërkohë që legjislacioni i posaçëm për gjykimet administrative është miratuar dy vite më vonë. Sipas këtij legjislacioni, janë parashikuar afate për kryerjen e veprimeve procedurale nga ana e gjykatës, respektimi me rigorozitet i të cilave, e bën të pamundur respektimin e standardit minimal kohor prej 1 muaj për kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve administrative.

Pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat ligjor shqyrtimi për kategori të caktuara çështjesh, (përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre) në të parashikohen afate ligjore për kryerjen e veprimeve procedurale, nga momenti i dorëzimit të çështjes, deri në përfundim të gjykimit, e konkretisht;

a) duke iu referuar parashikimeve të nenit 25, në të cilin parashikohet;

- afati 7 ditor për kryerjen e veprimeve paraprake,
- afati maksimal 10 ditor për plotësimin e të metave të padisë për paditësin,
- afati maksimal 10 ditor për depozitimin e prapësimeve me shkrim dhe provave nga pala e paditur,
- afati maksimal 20 ditor për kryerjen e ekspertimit në rast se vlerësohet i nevojshëm,
- afatit minimal 5 ditor për njoftimin e palëve për kryerjen e veprimeve si më sipër, veprimet

përgatitore zgjatin mesatarisht **47 ditë**.

b) nëse do të zhvillohet seancë përgatitore për të qartësuar natyrën e mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile, pas përfundimit të veprimeve paraprake, bashkë me kohën minimale të nevojshme për realizimin e njoftimeve të palëve, kjo fazë e gjykimit zgjat **15 ditë**.

c) pas zhvillimit të seancës përgatitore, caktimi i seancës gjyqësore, në referim të nenit 27 pika 1 të K.Pr.C , duhet të jetë brenda afatit ligjor **15 ditor**.

d) në rast se supozojmë që procesi gjyqësor do të zhvillohet në një seancë gjyqësore, duke marrë parasysh vetëm afatin **5 ditor** të parashikuar nga neni 302 i K.Pr.C për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare të palëve, dhe

e) afatin **5 ditor** të parashikuar nga neni 308 për shpalljen e vendimit të arsyetuar nga gjykata, kohëzgjatjes e gjykimit nga momenti i përfundimit të seancës përgatitore deri në shpalljen e vendimit do të ishte **25 ditë**.

Në tërësi, duke iu referuar afateve për zhvillimin e veprimeve procedurale si më sipër, nëse nuk ka zhvillime të tjera procedurale lidhur me njoftimin e palëve që diktojnë shtyrjen e seancave, gjykimi i një çështje administrative do të përfundonte për një afat minimal prej **87 ditësh**. Ky afat minimal kohor për përfundimin e gjykimit të çështjes administrative, është dukshëm më i gjatë se standardi minimal kohor prej 1 muaj i përcaktuar nga vendimi i KLD-së.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, standardi minimal kohor në fuqi prej 87 ditësh, sipas formulës së analizuar më sipër, nuk është respektuar në 7 nga 14 çështjet e analizuar, ose në 50% te tyre. Ndërkohë, respektimi i këtyre afateve, jo gjithmonë është varur nga gjyqtari. Nga analiza e tyre, rezulton se në disa raste shtyrja e gjykimit ka qenë për shkaqe të pavarura prej gjyqtarit, si njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve, pushimet vjetore gjatë muajit Gusht, festat zyrtare gjatë muajit Dhjetor dhe Janar.

.....

Duke analizuar 7 çështjet, të cilat rezultojnë se janë gjykuar përtej afatit 87 ditë, evidentohet se në 5 prej tyre, (dosja 7, 9, 10, 11, vendimi nr. 86), gjykimi ka zgjatur përkatësisht ; 4 muaj e 3 ditë, 5 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 10 ditë, 4 muaj e 26 ditë, dhe 3 muaj e 10 ditë.

Gjatë këtyre periudhave evidentohet se përfshihen periudhat e lejes vjetore gjatë muajit gusht dhe periudha e festave të fundvitit. Duke marrë parasysh edhe ; a) përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari dhe b) diferencën e vogël në kohë nga afati prej 87 ditësh, vlerësoj që këto 5 çështje të konsiderohen të gjykuara brenda afatit të standarit minimal.

Nisur nga analiza e mësipërme, rezulton përfundimisht se gjyqtari ka gjykuar jashtë afatit të standarit minimal kohor, vetëm 2 nga 14 çështjet e analizuara, ose 14 % të tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesataren”, duke e pikëzuar me 4 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.¹

Duke e konsideruar standard minimal kohor, afatin 87 ditor, sipas arsyetimit të bërë në analizën e treguesit 2.A.b, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për dy kategoritë, të cilave iu përkasin 14 çështjet e analizuar, rezulton se;

¹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.

⋮

- për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, të 9 prej tyre (vendimi 2, vendimi 3, dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 6, dosja 8, dosja 10 dhe dosja 11) është 2 muaj e 26 ditë, që do të thotë *më i shkurtër nga afati i standardit minimal*.

- për kategorinë e çështjeve “marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, të 5 prej tyre (vendimi 1, dosja 4, dosja 5, dosja 7 dhe dosja 9) është 4 muaj e 12 ditë, që do të thotë *më i gjatë nga afati i standardit minimal*.

Sipas metodologjise, nga leximi *i thjeshtë* i të dhënave statistikore, në këtë rast vlerësimi i aftësisë të gjyqtarit do të ishte në shkallën mesatare, duke e pikëzuar me 3 pikë. Kjo pasi, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e gjatë se standarti minimal kohor për *gjysmën* e katëgorive të çështjeve.

Ndërkohë, duke qenë së për të dyja këto kategori, afati i këtij standarti minimal është i njëjtë - 87 ditë, koha mesatare e gjykimit të 14 çështjeve të analizuara, është 103 ditë², pra vetëm *16 ditë më shumë nga afati i standartit*.

Duke analizuar të dhënat statistikore për çdo çështje, sipas arsytimit të bërë edhe në treguesin më lart, 2.A.b, nga kjo periudhë duhet të zbriten ; a) koha që i është dashur gjyqtarit për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej tij si ; *njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve, pushimet vjetore gjatë muajit Gusht, festat zyrtare gjatë muajit Dhjetor dhe Janar* dhe b) koha që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri te shortimi dhe dorëzimi te gjyqtari.

Gjithashtu, në këtë analizë duhet patur parasysh edhe; a) diferenca e vogël në kohë, 16 ditë më shumë nga afati prej 87 ditësh dhe, b) ngarkesën e gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ai ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve, sipas standartit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt 14.04.2010, të KLD-së.

Nisur nga kjo analizë, vlerësoj që koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është më e shkurtër se standarti minimal kohor prej 87 ditësh, dhe për këtë arsye, gjyqtari për këtë tregues duhet të vlerësohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

² Kohëzgjatja mesatare e gjykimit, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e gjykimit për tre vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari është e përafërt pasi për këto 3 burime nuk ka të dhëna për datën e shortimit apo mundësinë e rishortimit të çështjeve (për shkak të ndryshimit të trupit gjykues ose shkaqe të tjera) por vetëm për datën e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

·
·
·
·
·
·
·

2.A.ç **Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Nga të dhënat statistikore të administruara në dosje, për periudhën e vlerësimit të përbërë nga 4 vite kalendarike, rezultojnë se :

Në total në gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtari {...} rezultojnë të këtë gjykuar 1752 çështje, nga të cilat 461 çështje me palë kundërshtare të përgjithshme, 404 çështje me palë kundërshtare marrëdhënie pune, 849 çështje pa palë kundërshtare urdhëra ekzekutimi dhe 38 çështje pa palë kundërshtare kërkesa të tjera.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit si dhe mospërputhje të numrit të çështjeve të përfunduara në bazë të të dhënave statistikore me të dhënat e pasqyruara në Raportin e analizimit të aftësive profesionale, mbetet e pamundur përlogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 84.3 % i përcaktuar në faqen 29 të Raportit, faqe 963 i dosjes së rivlerësimit.

Duke iu referuar të dhënave nga raporti i mësipërm, rezultojnë se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë periudhës së vlerësimit, Tetor 2013- Tetor 2016, 1777 çështje, ose 592 çështje në vit. Nga këto të dhëna rezultojnë se gjyqtari ka gjykuar 592 çështje, disa herë më shumë se standardi minimal sasior i punës sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së³. Për këto arsye, vlerësoj se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari, pavarësisht se rezultojnë të jetë 84.3 %, duhet të pikëzohet me 6 pikë referuar Metodologjisë së Pikëzimit. Shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit lidhen me ngarkesën e punës disa herë më shumë se standarti minimal sasior i punës, gjatë viteve të vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “ Mesatare”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

³ Në “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, lidhur me standardin sasior të punës, në pikën 3 shkronja “c” parashikohet se :” *Standardi sasior i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë:.. c. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrativ, jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”.*

·
·
·
·
·
·
·

2.A.d *Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.*

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar.

Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsytimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “..Lidhur me kohën mesatare të arsytimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsytimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetjma e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara, është konstatuar se gjyqtari {...}, i ka kushtuar rëndësi arsytimit në kohë të vendimeve gjyqësore, pavarësisht ngarkesës sasiore që ai ka patur. Në 5 raste, vendimi është arsyetuar brenda afatit ligjor 7 ditor, nga ku rezulton se vendimi është dorëzuar i arsyetuar brenda ditës nga shpallja e tij (shih dosja nr.1), për 5 ditë (shih dosja nr 2), për 7 ditë (shih dosjet nr. 3 dhe 4), për 4ditë (shih dosja nr 5).”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja që i përket vendimit me nr. 6, datë 06.12.2013 është dorëzuar më datë 06.12.2016 (brenda ditës);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 66, datë 26.02.2014 është dorëzuar më datë 03.03.2014 (5 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 405, datë 27.07.2015 është dorëzuar më datë 03.08.2015 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 601 (549), datë 16.11.2015 është dorëzuar më datë 23.11.2015 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 985 (364), datë 05.09.2016 është dorëzuar më datë 09.09.2016 (4 ditë);

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë më datë 07.10.2020, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 08.09.2020, rezulton se:

- Dosja që i përket vendimit me nr. 86, datë 04.03.2014 është dorëzuar më datë 11.03.2014 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 545, datë 07.10.2014 është dorëzuar më datë 14.10.2014 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 188 (397), datë 22.07.2015 është dorëzuar më datë 29.07.2015 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 508, datë 20.10.2015 është dorëzuar më datë 27.10.2015 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 98 (49), datë 08.02.2016 është dorëzuar më datë 15.02.2016 (7 ditë);
- Dosja që i përket vendimit me nr. 116 (264), datë 30.03.2016 është dorëzuar më datë 05.04.2016 (6 ditë).

Referuar të dhënave si më sipër, për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton të jetë 5.8 ditë, më i shkurtër se afati i parashikuar në nenin 42 pika 3 të Ligjit nr.49/2012.

Duke iu referuar dy kategorive të çështjeve, rezulton se për kategorinë “çështje administrative me palë kundërshtare” (dosja 1, dosja 2, dosja 3, dosja 6, dosja 8, dosja 10 dhe dosja 11) koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 5.6 ditë ndërsa për kategorinë “marrëdhënie pune” (dosja 4, dosja 5, dosja 7, dosja 9) koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 6.25 ditë. Referuar të dhënave, koha mesatare rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural *për të gjitha* kategoritë e çështjeve” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Në pesë dosjet e vëzhguara rezultoi se në tre prej tyre gjykimi i çështjes ka përfunduar me pesë seanca nga të cilat, 3 përgatitore dhe 2 gjyqësore (shih dosja nr 1 dhe nr 3) dhe dy përgatitore dhe tre gjyqësore (shih dosja nr 4), me 6 seanca nga të cilat tre përgatitore dhe 3 gjyqësore (shih dosja nr 2), me 7 seanca nga të cilat 4 përgatitore dhe 3 gjyqësore (shih dosja nr 5). Këto të dhëna tregojnë se janë zhvilluar 28 seanca nga të cilat 15 seanca përgatitore dhe 13 seanca gjyqësore, nga të cilat; 2 seanca përgatitore jo produktive, zhvillimi i tyre ka dështuar për ; i) mungesë të gjyqtarit për shkak në ceremoni mortore (shih dosja nr 2 seanca nr 2), ii) mungesë të gjyqtarit në seminar trajnimi në Shkollën e Magjistraturës (shih dosja nr 3 seanca nr 2). Një seancë gjyqësore jo produktive. Zhvillimi i saj ka dështuar për ; i) mungesë të gjyqtarit për shkak familjare shëndetësore (shih dosja nr 2 seanca nr 1). Nga seancat e mësipërme përgatitore dhe gjyqësore rezultojnë të filluara me vonesë gjashtë seanca, nga 6 deri në 46 minuta nga të cilat ; një seancë gjyqësore me vonesë 6 minuta dhe 1 seancë përgatitore me vonesë 13 minuta, për shkak se gjyqtari ka qenë në një gjykim tjetër (shih dosja nr 1 seanca nr 1 dhe dy), seancë gjyqësore me vonesë 46 minuta, për shkak se ka qenë e zënë salla e gjyqimit (shih dosja nr 2 seanca nr 2), 1 seancë gjyqësore me vonesë 36 minuta, për shkak se gjyqtari ka qenë në një gjykim tjetër (shih dosja nr 4 seanca nr 1), dy seanca gjyqësore me vonesë 23 dhe 6 minuta, për shkak se gjyqtari ka qenë në një gjykim tjetër (shih dosja nr 5 seanca nr 1 dhe nr 2). Në të gjitha rastet, shkak i vonesës është i justifikuar dhe i treguar në procesverbal, vonesa lidhet me ngarkesën e lartë në punë të gjyqtarit dhe identifikimin e sallave të gjyqimit për regjistrimin e tyre në sistemin audio. Në asnjë rast, vonesa nuk ka sjellë pasoja tek palët apo në dështimin e seancave”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve administrative me palë kundërshtarë dhe marrëdhënie pune, lidhur me numrin e seancave gjyqësore, evidentohet si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short administruar në dosjen e rivlerësimit:

Dosja 1, çështja me nr. regjistri 02, datë regjistrimi 16.11.2013, nr. vendimi 6, datë vendimi 06.12.2013. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 2, çështja me nr. regjistri 36/54, datë regjistrimi 26.12.2013, nr. vendimi 66, datë vendimi 26.02.2014. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 seancë ka qenë joproductive (pasi gjyqtari nuk ka qenë në punë për arsye shëndetësore familjare).

Dosja 3, çështja me nr. regjistri 506, datë regjistrimi 11.05.2015, nr. vendimi 405, datë vendimi 27.07.2015. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 4, çështja me nr. regjistri (641)-00363, datë regjistrimi 04.09.2015, nr. vendimi 601 (549), datë vendimi 16.11.2015. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 5, çështja me nr. regjistri (345)-00171, datë regjistrimi 05.02.2016, nr. vendimi 985 (364), datë vendimi 05.09.2016. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 6, çështja me nr. regjistri 130, datë regjistrimi 22.01.2014, nr. vendimi 86, datë vendimi 04.03.2014. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

⋮
Dosja 7, çështja me nr. regjistri 530, datë regjistrimi 04.06.2014, nr. vendimi 545, datë vendimi 07.10.2014. Janë zhvilluar **3 seanca gjyqësore**, nga të cilat 1 seancë ka qenë joproduktive (*me qëllim njoftimin e palës së paditur, në kushtet kur nuk ka patur dijeni për seancën gjyqësore*).

Dosja 8, çështja me nr. regjistri 533, datë regjistrimi 22.05.2015, nr. vendimi 188 (397), datë vendimi 22.07.2015. Janë zhvilluar **2 seanca gjyqësore**, të cilat kanë qenë produktive.

Dosja 9, çështja me nr. regjistri 516, datë regjistrimi 15.05.2015, nr. vendimi 508, datë vendimi 20.10.2015. Janë zhvilluar **5 seanca gjyqësore**, nga të cilat 3 kanë qenë jo produktive (*për shkak të mospasjes tagër përfaqësimi për paditësin nga ana e avokait të tij, me qëllim njoftimin e paditësit në kushtet kur është konstatuar se nuk ka patur dijeni për datën dhe orën e gjykimit, si dhe për ti dhënë mundësi paditësit për tu përfaqësuar nga avokati i tij i cili për arsye familjare nuk mund të paraqitet*).

Dosja 10, çështja me nr. regjistri 730, datë regjistrimi 28.10.2015, nr. vendimi 98 (49), datë vendimi 08.02.2016. Është zhvilluar **1 seancë gjyqësore**, gjatë së cilës gjykimi ka përfunduar me shpalljen e vendimit përfundimtar.

Dosja 11, çështja me nr. regjistri 736, datë regjistrimi 04.11.2015, nr. vendimi 116 (264), datë vendimi 30.03.2016. Janë zhvilluar **6 seanca gjyqësore** nga të cilat 3 seanca kanë qenë joproduktive (*për shkak të mosparaqitjes të përfaqësuesit të palës paditëse për shkak të arsyeshme, për shkak të mospasjes dijeni të palës paditëse për seancën gjyqësore, si dhe për shkak të mungesës së gjyqtarit i cili ndodhej në një seminar në Tiranë*).

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në çështjet e vëzhguara variojnë nga 1 deri në 6 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar 11 çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 3 dhe gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : “Gjyqtari {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. në 5 dosjet e vëzhguara dosja është vënë në lëvizje ditën e paraqitjes apo të nesërmen, brenda afatit ligjor 7 ditor dhe kryen me korrektësi si në drejtim të veprimet përgatitore të përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr. 49/2012,

Seancat përgatitore janë zhvilluar në mënyrë korrekte dhe të plotë duke evidentuar në çdo rast verifikimin e paraqitjes së palëve, relatimin lidhur me aktet e njoftimit të palëve dhe paraqitjen ose jo të tyre. Pas zhvillimit të veprimeve të përcaktuara në nenin 158/b të K.Pr.C, ka disponuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore e cila në çdo rast, në 11 dosjet e vëzhguara është caktuar brenda afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 27 pika 1 të ligjit nr. 49/2012. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, pasqyruar në procesverbalin e seancës përgatitore, përmban elementët e përcaktuar në nenin 27 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 si dhe paralajmërimin për pasojat e mosparaqitjes së provave para zhvillimit të seancës së parë gjyqësore sipas përcaktimeve të nenit 27 pika 3 të ligjit nr.49/2012.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur në mënyrë manuale ose me regjistrim audio. Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.C dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre; relatimin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni për palët që nuk janë paraqitur; deponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura; shpalljen e gjykatës; dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake; disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla; deklarimin e hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave; administrimin e provave; dhënien fjalën palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor; deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor; deponimin me vendim për kërkesat e palëve për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare; dhënien fjalën palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe, kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosjet e vëzhguara seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht në orarin e caktuar, por edhe kur ka patur vonesa në fillimin e seancave, është relatuar shkaku i fillimit të tyre me vonesë.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

•
•
•
•
•
•
•
•
•
•

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“...Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikpamja formale. Kronologjia e rradhitjes së akteve në dosje sipas standartit nuk mund të vlerësohet, pasi nuk është verifikuar origjinali por fotokopje të sjella nga gjykata. Në pesë dosjet e vëzhguara janë inventarizuar aktet proceduriale...”*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes konstatohet se, aktet në dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e dosjes ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre. Renditja e akteve në dosje, e cila në përgjithësi nuk është e njëjtë në të gjitha dosjet, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta nën aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarit renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e ateve që përfshihen në to. Në dosje gjenen të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpatria, fleta e shortit, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, fletëthirrjet, provat, kërkimet përfundimtare të palëve etj..”*

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e paraqitura nga palët, aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e seancës gjyqësore, vendimet gjyqësore, procesverbali audio). Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet që dokumentacioni në dosje, është në përputhje me veprimet procedurale të kryera, nuk ka mungesa, dhe se është i duhuri.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion.

⋮

Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3. A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cënim të etikës apo përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtares, gjatë ushtrimit të funksionit.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3. B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin {...} në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

.....

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave të nisur gjatë periudhës së vlerësimit (analizuar në treguesin më sipër), nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe **nuk** rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integriteti të gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3. C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit që lidhen me respektimin e rregullave procedurale dhe me standardin e gjykatës së paanëshme*”.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari, në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton që gjyqtari, të ketë përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtëpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit si dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

•
•
•
•
•
•
•

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësisë të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A. a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale hartuar në kuadër të rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se : *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor dhe në shkresat drejtuar palëve të treta, është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me pjesëmarrësit në proces dhe jashtë tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore”*.

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët është i qartë, transparent dhe i kuptueshm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar pretendimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent, me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësi e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar burimeve të vlerësimit, **nuk** rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve, apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, gjyqtari në këtë tregues, vlerësohet në nivelin “Shumë i lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

⋮

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësitë e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, prezumohet se ai ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës me nr. 780 prot, datë 21.10.2016, rezulton se gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit ka qenë pjesëmarrës në aktivitetet trajnuese si më poshtë:

1. Tema “Normat standarte të trajtimit të të miturve në sistemin e drejtësisë dhe teknikat miqësore të intervistimit dhe të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin, viktimat apo dëshmitarë”, trajnim i zhvilluar në datë 29 tetor 2013.
2. Tema “Zbatimi i Sistemit të Drejtësisë Administrative në Shqipëri”, trajnim i zhvilluar në datë 22 nëntor 2013.
3. Tema “Gjykimi administrativ sipas ligjit të ri nr. 49/2012, trajnim i zhvilluar në datë 23 dhjetor 2013.
4. Tema “Faza e ekzekutimit të procesit gjyqësor administrativ sipas ligjit të ri nr. 49/2012”, trajnim i zhvilluar në datë 24 dhjetor 2013.
5. Tema “Prokurimi publik dhe praktika gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datë 22-23 prill 2014.
6. Tema “Aspekte procedurale të të drejtës së padisë. (Parimi i dispon{...}litetit të padisë; ngritjen dhe praktikën gjyqësore kontradiktore lidhur me këtë çështje; shkaqet ligjore të prishjes së vendimeve nga gjykatat më të larta)”, trajnim i zhvilluar në datë 26-27 maj 2014.
7. Tema “E drejta administrative”, trajnim i zhvilluar në datë 2-4 korrik 2014.
8. Tema “Legjislacionin tatimor dhe prokurimin publik”, trajnim i zhvilluar në datë 14 nëntor 2014.
9. Tema “Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me përbërësit e gjëndjes civile dhe legjislacionin përkatës”, trajnim i zhvilluar në datë 11-12 dhjetor 2014.
10. Tema “Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me legjislacionin në fushën e tatimeve (Aspektet ligjore, aspektet praktike, jurisprudenca e GJL-së)”, trajnim i zhvilluar në datë 30 janar 2015.
11. Tema “Ndihma juridike në fushën civile dhe administrative. Roli i Komisionit Shtetëror të Ndhmës Juridike në zbatim të ligjit nr. 10039/22, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, trajnim i zhvilluar në datë 10 shkurt 2015.
12. Tema “Problematika që përcillet në gjyqësorin shqiptar në lidhje me zbatimin e legjislacionit në fushën e doganave”, trajnim i zhvilluar në datë 23 shkurt 2015.
13. Tema “Etika profesionale”, trajnim i zhvilluar në datë 3 mars 2015.
14. Tema “E drejta e BE-së dhe praktika gjyqësore”, trajnim i zhvilluar në datë 25-26 mars 2015.
15. Tema “Të drejtat e njeriut”, trajnim i zhvilluar në datë 30-31 mars 2015.
16. Tema “Reforma e sistemit gjyqësor (Problematika e procedimit disiplinor të gjyqtarëve dhe praktika gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të GJL-së në këtë drejtim. Vetëqeverisja, si dhe kompetencat e kryetarit të gjykatës dhe të kancelarit në administrim, si figura drejtuese. Zbatimi i sistemit të vlerësimit profesional të gjyqtarëve.)”, trajnim i zhvilluar në datë 28 prill 2015.
17. Tema “Birësimi i fëmijëve dhe problemet e praktikës gjyqësore në proceset e birësimit. Instituti i amësisë dhe atësisë në këndvështrimin e praktikës tonë gjyqësore shqiptare dhe të GJEDNJ-së”, trajnim i zhvilluar në datë 26-27 maj 2015.
18. Tema “Problematika e çështjeve që kanë lidhje me legjislacionin për sigurimet shoqërore. (Anullimi i akteve administrative të Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore. Çështjet për caktim pensioni dhe mbyllje pensioni (për ushtarakët dhe kategori të tjera), trajnim i zhvilluar në datë 9-10 qershor 2015.
19. Tema “Drejtësia administrative”, trajnim i zhvilluar në datë 29-30 qershor 2015.
20. Tema “Rregullimi ligjor i marrëdhënieve të punës dhe problemet që ndeshën në praktikën gjyqësore në kuadër të zbatimit të dispozitave të Kodit të Punës dhe ligjit 49/2014 SI DHE LIGJIT NR. 152/2013 “Për nënpunësit civil”. Përfundimin e marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës dhe Lirimi nga shërbimi civil; Transferimi sipas Kodit të Punës dhe legjislacionit të shërbimit civil (transferimi i përkohshëm dhe i përhershëm). Dallimi mes gjykimit administrativ dhe atij civil, në

aspektin e zbatimit të rregullave procedurale të parashikuara në ligjin 49/2012 dhe K.Pr.C. Roli i gjykatës civile dhe administrative në këto gjykime dhe trajtimi i problemeve që shfaqen aktualisht”, trajnim i zhvilluar në datë 9-10 korrik 2015.

21. Tema “Kodi Administrativ”, trajnim i zhvilluar në datë 10 shtator 2015.
22. Tema “Zhvillime të legjislacionit fiskal, në këndvështrimin e gjykimeve administrative”, trajnim i zhvilluar në datë 18 nëntor 2015.
23. Tema “Etika profesionale”, trajnim i zhvilluar në datë 5 shkurt 2016.
24. Tema “Shkrimi ligjor dhe arsytimi i vendimeve gjyqësore, elementët e tij sipas dispozitave procedurale dhe materiale. Pasojat e mosarsyemit të vendimit”, trajnim i zhvilluar në datë 16 mars 2016.
25. Tema “Juridiksioni kushtetues vs Juridiksioni gjyqësor administrativ”, trajnim i zhvilluar në datë 17-18 mars 2016.
26. Tema “Kontrabanda. Zgjidhja administrative e kontrabandës”, trajnim i zhvilluar në datë 24-25 mars 2016.
27. Tema “Institute të së drejtës procedurale administrative sipas Kodit të ri të Procedurave Administrative”, trajnim i zhvilluar në datë 12 prill 2016.
28. Tema “Procedimi disiplinor i gjyqtarëve (të dhëna bazë mbi procedurë dhe kriteret, si dhe përqasja me praktikat e mira evropiane).”, trajnim i zhvilluar në datë 30 maj 2016.
29. Tema “Nënshkrimi elektronik. Garancitë e përdorimit të dokumentit elektronik dhe ligji mbi nënshkrimin elektronik”, trajnim i zhvilluar në datë 7 qërshor 2016.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës administrative, në cilësinë e pjesëmarrësit gjithsej 29 aktivitete, në 41 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tri vjeçare.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit*, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues gjyqtari, vlerësohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se për periudhën e vlerësimit, për gjyqtarin nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këtë tregues. Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se, *për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit*, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari.

Sipas provave të paraqitura nga gjyqtari, bashkëlidhur kundërshtimeve të tij në lidhje me projektraportin e vlerësimit, rezulton se gjyqtari është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata. Gjyqtari, ka marrë pjesë në tavolina konsultimi duke dhënë kontribut në përmirësimin e legjislacionit, kryesisht në procesin e draftimit e paketës ligjore në lidhje me reformën në drejtësi. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, kjo

.....
pjesmarrje vlerësohet si angazhim në këto lloj veprimtarish. Duke qenë se edhe periudha e këtij angazhimi, përfaqësohet gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Dosja e rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, **nuk** rezulton që gjyqtari, gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi; Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, gjyqtari vlerësohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

.....

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	95	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	380	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR